

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot me date 16.02.2023 (dymijenjëzetetre), lidhet kjo kontrate e shitje se kuotave te pjesëmarrjes ne kapitalin e regjistruar te shoqërisë “M.B INVEST” sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C, me seli ne Tirane, Rr. "Ndreko Rino", pallati i ri, pasuria nr.7 / 708-N1, zona kadastrale 8270, vol. 103, faqe 108 midis palëve si me poshtë:

SHITES; Z. Abaz Nezir DINO, shtetas Shqiptar, lindur me 29.01.1967 ne Ballsh dhe banues ne Tirane, ne Rr. “Rrapo Hekali”, pranë Kultit “Eleonor” Selite, Tirane, madhor e me zotësi te plote juridike dhe për te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 024472278 dhe Nr. personal G70129065N.

BLERES; Znj. Sindi Abaz DINO, shtetase Shqiptare, lindur me 09.06.2000, ne Fier dhe banuese ne Tirane, Rr.“Rrapo Hekali”, pranë Kultit “Eleonor” Selite, madhore, me zotësi te plote juridike dhe për te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 033152169 dhe Nr. personal K05609060K.

BAZA LIGJORE; Referuar dispozitave ligjore: Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, Ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare Te Regjistrimit” me ndryshimet e mëvonshme, Kodi Civil, Akt Themelim e Statut i Shoqërisë.

OBJEKTI; Shitje e tërësisë se kuotave te zotëruara nga shitësi, Z.Abaz Dino ne shoqërinë tregtare “M.B INVEST” sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C te blerësi dhe blerja nga Znj.Sindi DINO te një kuote ne masën 100% te kapitalit themeltar ne këtë shoqëri.

Me hartimin dhe nënshkrimin e kësaj Kontrate Z.Abaz Dino humb tërësisht te drejtat e pronësisë mbi kuotën e zotëruar nga ana e tij deri para nënshkrimit te kësaj kontrate ne shoqërinë tregtare “M.B INVEST” sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C, si dhe çdo te drejte reale qe buron nga zotërimi i kuotës deri me tani apo dhe detyrim te tij me këtë shoqëri, pronësi e cila me regjistrimin e kësaj kontrate ne QKB kalojnë plotësisht te;

- Znj.Sindi DINO te një kuote ne masën e 100% te kapitalit themeltar kundrejt vlerës totale 100.000 (njëqind mije) leke. Çmimi, vlera monetare, e këtij transaksioni është likuiduar ne zyrat e Shoqërisë pa patur pretendim mes tyre ku shitësi deklaroi se i ka marre ato.

Mbas nënshkrimit te këtij Akti e pasqyrimit e tij ne QKB, Shoqëria tregtare “M.B INVEST” sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C pëson këto ndryshime:

Ishte: Shoqëria tregtare “M.B INVEST” sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C dhe me 1(një) kuote me Ortak te Vetëm Z.Abaz Dino zotërues i 1 (një) kuote me vlere 100% te kapitalit ne Shoqëri.

Behet: Shoqëria tregtare “M.B INVEST” sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C me 1 (nje) kuote qe përfaqëson 100% te kapitalit te saj themeltar dhe me Ortake Znj. Sindi DINO te 1 (një) kuote ne masën e 100% te kapitalit themeltar.

Kjo Kontrate u përpilua ne katër kopje me vlere te njëjte ligjore, e cila pasi lexohet prej palëve te interesuara me zë te larte e te qarte, kuptohet prej tyre, deklarohet se u gjet e përpiluar ne përputhje me vullnetin e tyre te lire e te plote si dhe me Ligjin e për rrjedhojë u nënshkrua rregullisht prej tyre si me poshtë.

SHITESI

Abaz Nezir DINO

Abaz DINO


BLERESI

Sindi Abaz DINO

Sindi DINO
